



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROKURORIA E PËRGJITHSHME
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

SHPALLJE PËR LËVIZJE PARALELE DHE PËR PRANIMIN NË SHËRBIMIN CIVIL NË KATEGORINË E ULËT DREJTUESE (përgjegjës sektori)

Njoftim për vënd pune të lirë në administratë në pozicionin “përgjegjës sektori, ne Sektorin Burimeve Njerëzore , në Prokurorinë e Përgjithshme.

Prokuroria e Përgjithshme, shpall konkurrimin për nëpunës civil të kategorisë ekzekutive III-a, për vëndin e punës në pozicionin “përgjegjës sektori”. Proçedura e rekrutimit, përzgjedhjes dhe periudha e provës do të realizohet:

Pozicionet më sipër, u ofrohen fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele!

Vetëm në rast se nga këto pozicione, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ende ka pozicione vakante, ato janë të vlefshme për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive.

Për të dy procedurat (lëvizje paralele dhe pranim në shërbimin civil në kategorinë e ulët drejtuese) aplikohet në të njëjtën kohë!

Data e dorëzimit të dokumentave: 18.02.2018

****Afati i aplikimit dhe dorëzimit të dokumentacionit është i njëjtë për të dyja procedurat.***

Konkurrimi për vëndin e punës në pozicionin “përgjegjës sektori” në Sektorin e Burimeve Njerëzore, në Prokurorinë e Përgjithshme Tiranë, do të bazohet në:

- Njohuritë për Kushtetuten e Republikës së Shqipërisë;

- Ligjin nr.97/2016, “Për organizimin e funksionimin e Prokurorisë së Përgjithshme;

- Ligjin nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”;

- Kodin e Proçedurave Administrative;

- Kodi i Punës

Ligji 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në RSh

- Ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar;

- Ligjin nr. 9049, datë 10.4.2003, “për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar;

- Rregulloren e Brendshme të Prokurorisë së Përgjithshme;

- Në aftësitë individuale, profesionale bazuar në jetëshkrimin, që konsiston në nivelin e llojit të arsimit, përvojës, trajnimeve të lidhura me fushën, si dhe vlerësimet e arritjeve të vjetra;

b) Konkurrimi do të zhvillohet në dy faza:

i. Faza e parë:

- Verifikimi paraprak i kandidatëve për plotësimin e kërkesave të përgjithshme dhe atyre të veçanta të përcaktuara në shpalljen për konkurim

- Sekretari i Përgjithshëm dhe Sektori i Burimeve Njerëzore në bazë të dokumentacionit të paraqitur, jo më vonë se 5 (pesë) ditë pune nga data e mbylljes së pranimit të tyre, do të bëjë verifikimin paraprak të kandidatëve, që përmbushin kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta, të përcaktuara në shpalljen për konkurim

- Kandidatët që plotësojnë kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta të pozicionit të punës, renditen në një listë sipas rendit alfabetik e cila administrohet në S.B.Nj dhe do të shpallet në faqen zyrtare të internetit PP dhe në hyrjen kryesore të Prokurorisë së Përgjithshme.

- Kandidatët, që nuk plotësojnë kërkesat e përcaktuara në shpalljen për konkurim, renditen në një listë të veçantë në të cilën regjistrohen edhe arsyet e mosplotësimit të këtyre kërkesave. Kjo listë nuk publikohet dhe administrohet në S.B.Nj e cila njofton në mënyrë individuale kandidatët që nuk janë kualifikuar.

- Çdo kandidat ka të drejtë të paraqesë ankese pranë Sekretarit të Përgjithshëm, brenda 5 (pesë) ditëve kalendrike nga data e shpalljes së listës. Ankuesi mer për gjigje brenda 5 (pesë) ditëve kalendrike nga data e depozitimit të ankesës

ii. Faza e dytë përbehet nga vlerësimi i kandidatëve që përfshin:

- Vlerësimin e jetëshkrimit të kandidatëve, që konsiston në vlerësimin e arsimit, të eksperiencës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, si dhe vlerësimet e arritjeve të vjetra

- Vlerësimi me shkrim.

- Intervista e strukturuar me gojë.

c) Pranimi do të bëhet për 1 (një) vend pune në pozicionin “**përgjegjës sektori**”.

ç) Për pranimin në shërbimin civil, kandidati duhet të plotësojë kërkesat e përgjithshme sipas nenit 21, të ligjit nr.152/2013, “Per nepunesin civil”, i ndryshuar, si më poshtë:

- Të jetë shtetas shqiptar.
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar.
- Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur.
- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse.
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje.
- Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas këti ligji.
- Te ketë 3 vleresimet e fundit “shume mire”.

D) Vendi i punes ne pozicionin pozicionin “**përgjegjës sektori**” ben pjese në grupin e administrimit te posaçem. Ai vepron nën autoritetin e DREJTORIT TE DREJTORISE SE NDIHMËS PËR SUBJEKTET E POSAÇME, MBROJTJES SË DËSHMITARËVE, INSPEKTIMIT DHE BURIMEVE NJERËZORE, STUDIMEVE, PROJEKTEVE ”, ka këto detyra dhe përgjegjësi kryesore, por jo vetëm:

- a) - administron dokumentacionin me të dhënat vetjake të kandidatëve për prokurorë, prokurorëve, juristëve të seksioneve të Policisë Gjyqësore, të nëpunësve civilë dhe punonjësve të tjerë në organin e Prokurorisë;
- b) përgatit dokumentacionin përkatës për emërime, transferime, ngritje në detyrë dhe shkarkime të prokurorëve, juristëve - oficerë të policisë gjyqësore të Prokurorive dhe punonjësve të tjerë të kësaj Zyre dhe të Prokurorive të të gjitha niveleve që janë emërtesë e Prokurorit të Përgjithshëm;
- c) administron trajnimet periodike vazhduese të prokurorëve dhe të policisë gjyqësore, për ngritjen e nivelit profesional të tyre, duke bashkërenduar me Drejtorinë e Studimeve, Kërkimeve Ligjore dhe Integritit të kësaj Zyre dhe me Shkollën e Magjistraturës, si dhe me pjesëmarrësit në trajnime;
- ç) harton programet e trajnimit të administratës së Prokurorive, bazuar në prioritetet ose shqetësimet e praktikës dhe administron dokumentacion përkatës;
- d) harton listat për të gjithë punonjësit që mbartin detyrimin për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve në mbeshtetje të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003.
- dh) **kryen funksione të tjera të caktuara me ligj ose me urdhër të posaçëm.**

DH) Kërkesat e veçanta te grupit te administrimit te posaçem jane:

Te kete perfunduar arsimin e larte dhe te jete diplomuar ne degen juridik me diplome te nivelit Master profesional.

- Prioritet perben nje diplome e nivelit me te larte ose titull shkencor sipas kategorise se vendit te punes.

- Te kete pervoje pune, jo me pak se 10 vjet, dhe specifikisht pervoja e punes e ngjashme me detyrat kryesore qe do te kryeje ne kete pozicion pune.

- Te kete pervoje ne organet e Drejtesise.

- Te zoteroje me deshmi metodat e reja te informacionit dhe te kete aftesi shume te mira te perdorimit te PC-se ne programet baze te tij.

- Te kete aftesi te mira komunikimi dhe te punes ne grup.

e) Lista e dokumentave qe duhet te dorezohen, sipas lidhjes nr.1, qe i bashkelidhet njoftimit. Menyra e dorezimit me poste ose e drejtperdrejte ne protokollin e institucionit me adrese: Prokuroria e Përgjithshme/Sekretari i Përgjithshëm (konkurrimi per vendin e punes ne pozicionin “Pergjegje sektori”) me adrese: Rruga “Qemal Stafa, nr.1, Tirane.

ë) Afati i dorezimit te dokumentave eshte data **18.02.2018**, i cili eshte jo me vone se 30 ditë kalendarike nga dita e pare e shpalljes ne faqen elektronike dhe tek dera e Prokurorisë së Përgjithshme. Per dokumentat qe dorezohen me poste data e dorezimit eshte ajo e vules postare ne momentin e pranimit te objektit postar.

f) Data e daljes se rezultateve per fazen e vleresimit paraprak te kandidateve eshte **22.02.2018**

g) Konkurrimi per vendin e punes ne pozicionin “pergjegje sektori ” do te zhvillohet te Prokuroria e Përgjithshme, salla e mbledhjeve ne adresen: Rruga “Qemal Stafa nr.1, Tirane.

gj) Menyra e vleresimit te kandidateve:

- Vleresimi i jeteshkrimit te kandidateve, qe konsiston ne vleresimin e arsimimit, te eksperiences e te trajnimeve, te lidhura me fushen, si dhe vleresimet e arritjeve vjetore;

- Vleresimi me shkrim;

- Intervista e strukturuar me goje.

- Totali i pikeve te vleresimit te kandidateve eshte 100, te cilat ndahen perkatesisht:

÷ Per vleresimin e jeteshkrimit (cv) te kandidateve, qe konsiston ne vleresimin e arsimimit, te eksperiences e te trajnimeve, te lidhura me fushen, si dhe vleresimnet e arritjeve vjetore, 15 pike;

÷ Per intervisten e strukturuar me goje, 15 pike;

÷ Per vleresimin me shkrim, 70 pike.

i) Menyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatet do te behet nepermjet adresave te e-mail-eve, me mesazhe ne numrin e celularit, ne faqen e internetit dhe tek dera e Prokurorisë së Përgjithshme.

Per me shume informacion per Prokurorinë e Përgjithshme dhe veprimtarine e saj mund te vizitoni edhe faqen tone ne internet: www.pp.gov.al

Per sqarime te metejshme mund te kontaktoni me numrin telefonik (0694113043), ose ne adresen: Prokuroria e Përgjithshme, e Republikës se Shqipërisë, Rruga “Qemal Stafa nr.1, Tirane.

PROKURORIA E PERGJITHSHME

TIRANE MË 23.01.2018